



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Primierno/Pridata Received/Delivery	15.05.2023	3	viti god. year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Bri Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SH/CIK	4226/2023		1/13



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.591/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.549/2023 të datës 23.03.2023 të parashtruar nga ankuesja dhe ankesën me numër A.nr.591/2023 të datës 31.03.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Agjencisë për Informim dhe Privatësi, të bashkuar përmes Vendimit me numër protokolli 4150/2023 të datës 08.05.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në ankesë me numër A.nr.591/2023, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.549/2023 të datës 23.03.2023 të parashtruar nga ankuesja dhe ankesa me numër A.nr.591/2023 të datës 31.03.2023 të parashtruar nga ankuesi të bashkuar në ankesën me numër A.nr.591/2023.

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi më datë 25.01.2023 ka shpallur njoftimin lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00010839 për pozitën Drejtor i Përgjithshëm 1, ku afati për aplikim ka qenë nga data 24.02.2023 deri më datë 03.03.2023. Tutje në këtë konkurs kanë aplikuar edhe ankuesit dhe mirëpo në bazë të njoftimit të datës 07.03.2023 të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Agjencisë për Informim dhe Privatësi

ankueses i është refuzuar aplikacioni për shkak që nuk ka ofruar dëshmi për me të cilën tregon interesim për aplikim në këtë pozitë gjegjësisht nuk ka dërguar letër motivuese, ndërsa e njëjta më datë 10.03.2023 i është drejtuar me kërkesë për vlerësim të drejtë të aplikacionit, kurse më atë 14.03.2022 nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Informim dhe Privatësi ankuesja është njoftuar se nuk ka dorëzuar letër motivimi e cila është kërkesë e konkursit. Tutje në bazë të njoftimit të datës 07.03.2023 ankuesi është njoftuar se ka plotësuar kushtet e konkursit për të vazhduar me procedurat tjera.

Ankuesja kundër njoftimit të datës 07.03.2023 dhe 14.03.2023, më datë 22.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 23.03.2023v me numër protokoll 2905/2023.

Pas procedurave të tjera respektivisht testimit me shkrim dhe intervistës, është bërë vlerësimi i kandidatëve në bazë të të cilave rezultojnë se ankuesi në testin me shkrim ka marrë gjithsej 28.05 pikë, në intervistë me gojë gjithsej 11.5 pikë, ndërsa nga vlerësimi i të dyja fazave ka marrë gjithsej 39.55 pikë, me çka rezultojnë se nuk ka marrë pikët e nevojshme të jetë kandidat i listës fituese, ndërsa për këtë rezultat është njoftuar më datë 30.03.2023.

Ankuesi më datë 31.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3168/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 30.03.2023 të lëshuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.05.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokoll 4150/2023 përmes të cilit ka bërë bashkimin e ankesës me numër A.nr.538/2023 të datës 23.03.2023 të parashtruar nga ankuesja dhe ankesës me numër A.nr.591/2023 të datës 31.03.2023 të parashtruar nga ankuesi për shkak që faktet dhe baza ligjore për vendimmarrje është e njëjtë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 2905/2023 të datës 23.03.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin nga ankuesja B.B për ankesa.kpmshck@rks-gov.net të datës 22.03.2023; Emailin nga ankuesja për A.S. i datës 02.03.2023; Emailin nga SIMBNJ për ankuesen e datës 07.03.2023; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore e datës 07.03.2023; Emailin nga A.S. për ankuesen i datës 07.03.2023; Emailin nga ankuesja për A.S. i datës 10.03.2023; Emailin nga A.S. për ankuesen i datës 07.03.2023; Emailin nga A.S. për ankuesen i datës 14.03.2023; Emailin nga SIMBNJ për ankuesen i datës 14.03.2023; Emailin nga ankuesja për A.S. i datës 20.03.2023; Vendimin A.nr. 492/2022 i datës 04.07.2022 i Këshillit; Vendim me Nr.03/01/2022 i datës 24.05.2022; Emailin e datës 21.03.2022 nga A.S për ankuesen; Emailin nga Ankuesja për A.S. të datës 17.03.2022; Vendim me Nr.03/2022 i datës 14.03.2022; Vendimin me Nr. 85/2016 të datës 01.07.2016 të Këshillit; Lista e kandidatëve të ftuar për intervistë me gojë për pozitën

Drejtor i Departamentit Ligjor Ministria e Financave; Emailin e datës 30.05.2016 nga O.D. për ankuesen etj; Emailin nga O.D për N.B dhe të tjerët i datës 30.05.2016; Njoftim nga Ministria e Financave me numër protokolli 847 i datës 28.04.2016; Raporti përfundimtar i kërkesave të pranuarra i datës 18.05.2016; Vendim për emërimin e komisionit përzgjedhës të shërbimit civil (KPSHC) me numër Nr.77/2016 i datës 18.05.2016; Deklaratë me numër protokolli 991-1 i datës 18.05.2016; Raporti i përgatitjes së listës së shkurt për Drejtor të Departamenti Ligjor i datës 23.05.2016; Emailin nga O.D për N.B dhe të tjerët i datës 18.05.2016; Njoftim për mbajtjen e testeve me shkrim Ministria e Financave me numër protokolli 1022 i datës 23.05.2016; Emailin nga O.D për G.S dhe të tjerët i datës 23.05.2016; Emailin nga O.D për B.B dhe të tjetër i datës 23.05.2016; Emailin nga R.K. për N.B dhe të tjerët i datës 25.05.2016 dhe 31.05.2016; Raport përfundimtar lidhur me procedurat e rekrutimit Drejtor i Departamentit Ligjor Ministria e Financave i datës 09.06.2015; Raport/Njoftim për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm me numër protokolli 991-2 i datës 09.06.2016; Njoftim për mbajtjen e testimit me gojë intervistës Ministria e Financave me numër protokolli 1077 i datës 30.05.2016; Certifikatën mbi dënimet penale e ankueses e datës 02.03.2023; Emailin nga A.S. për ankuesen i datës 21.03.2022; Vendim me Nr.03/2022 i datës 14.03.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 3345/2023 të datës 06.04.2023; Ankesën me numër protokolli 3168/2023 të datës 31.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 30.03.2023 lidhur me kandidatët fitues; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 3334/2023 e datës 05.04.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 3470/2023 e datës 12.04.2023; Vendimin me Nr.26/2022 të datës 21.12.2022 për Emërimin e Komisionit të Pranimit; Njoftimin për listën e ngushtë të kandidatëve të datës 07.03.2023; Njoftim i datës 14.03.2023 i dërguar me email nga A.S për XH.Z; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Njoftim i datës 30.03.2023 i dërguar me email nga A.S për Xh.Z; Njoftim për kandidatët fitues i datës 30.03.2023; Lista e Aplikantëve; Konkursi me numër reference RN00010839 të shpallur me datë 25.01.2023 nga Agjencia për Informim dhe Privatësi lidhur me pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm 1; Njoftim i datës 23.03.2023 i dërguar me email nga A.S për Xh.Z: Udhëzues për kandidatët-Faza e vlerësimit profesional; Njoftim i datës 14.03.2023 i dërguar me email nga A.S për Xh.Z; Intervista-Marrja e shënimeve e datës 28.03.2023 e kandidatit Xh.Z nga vlerësuesi L.S; Intervista-Marrja e shënimeve e datës 28.03.2023 e kandidatit Xh.Z nga vlerësuesja A.K; Intervista-Marrja e shënimeve e datës 28.03.2023 e kandidatit Xh.Z nga vlerësuesja A.S; Intervista-Marrja e shënimeve e datës 28.03.2023 e kandidatit Xh.Z nga vlerësuesi N.G; Intervista-Marrja e shënimeve e datës 28.03.2023 e kandidatit Xh.Z nga vlerësuesi B.XH; Prova shtesë me numër protokolli 3552/2023 të datës 14.04.2023 të dërguara nga Agjencia për Informim dhe Privatësi për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aplikacionin e kandidatit B.K i datës 03.03.2023; Diplomë Master me Nr. 2671 e datës 07.04.2006; Vendimin me Nr. 6-774 i datës 18.09.2014; Diplomën me Nr. 550 të datës 05.06.2003; Vendimin me Nr. 924 të datës 28.09.2020; Kontratë Punë me Nr. Prot: 162/18 e datës 04.04.2018; Vendimin me Nr. 01/2017 i datës 26.09.2017; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 19.02.2013; Kontratë e marrëdhënies së punës me Nr. 042/05 e datës 26.05.2011; Kontratë e marrëdhënies së punës Nr.042/4 e datës 19.06.2008; Kontratë e marrëdhënies së punës me

Nr. 042/2 e datës 19.06.2006; Kontratë e marrëdhënies së punës Nr. 042/3 e datës 19.06.2007; Kontratë e Marrëdhënies së punës me Nr. 509/05 e datës 02.09.2005; Marrëveshje e veçantë e shërbimit e datës 01.07.2005; Vërtetimin e datës 11.04.2017; Letër rekomandimin e datës 13.04.2017; Letër rekomandimin e datës 16.05.2018, 07.07.2021; Dokument identifikimi i kandidat B.K; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 31.01.2023, 07.02.2022, 28.01.2022; Vërtetimin e datës 02.03.2023; Letër Motivimi e datës 02.03.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 02.03.2023; Aplikacioni i kandidatit A.A i datës 28.02.2023; Diplomë nga Kolegji Viktori me numër Nr.006/10 i datës 24.01.2011; Diplomë nga Kolegji Viktori me numër Nr.155/13 i datës 11.11.2013; Referencë nga Kosova Petrol për kandidatin A.A.; Referencë nga ORBICO e datës 20.01.2020; Vendim nga Komuna e Mitrovicës së Jugut e datës 20.08.2018; Dokument identifikimi për kandidatin A.A; Pasqyra e llogarisë e trustit për kandidatin A.A. prej datës 03.01.2010-16.09.2022; Vërtetim nga Komuna e Mitrovicës së Jugut për kandidatin A.A e datës 24.10.2022; Certifikatë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë për kandidatin A.A i datës 26.09.2022; Letër motivuese e kandidatit A.A e datës 28.08.2023; Aplikacioni i kandidatit L.B i datës 03.03.2023; Diplomë e studimeve themelore universitare nga Globus me numër Nr.067/12 i datës 30.10.2012; Diplomë e Masterit nga Globus me numër Nr.009/19 i datës 22.02.2019; Vërtetim nga MPB-AKSP për kandidatin L.B. i datës 17.01.2017; Kontrata e marrëdhënies së punës e kandidatit L.B. e datës 12.01.2009; Kontrata e marrëdhënies së punës e kandidatit L.B e datës 01.01.2010; Kontrata e marrëdhënies së punës e kandidatit L.B e datës 02.04.2009; Kontrata e marrëdhënies së punës e kandidatit L.B e datës 31.01.2010; Vërtetim nga MPB-AME për kandidatin L.B i datës 16.01.2020; Vërtetim nga KCG për kandidatin L.B i datës 01.06.2014; Akt Emërim i kandidatit L.B. i datës 19.12.2016; Akt Emërim i kandidatit L.B i datës 13.12.2019; Vërtetim për bashkëpunim për trajnime i datës 17.09.2019; Kontratë për trajnimin e të punësuarve në administratë publike e kandidatit L.B i datës 25.02.2021; Kontratë mbi vepër nga IKAP e kandidatit L.B. i datës 29.10.2018; Letër referencë për kandidatin L.B. me nr. protokolli 315/21 e datës 22.04.2021; Kontratë për ekspert të jashtëm profesional të prokurimit dhe ekspert të jashtëm teknik sipas nevojave të OSHP-së me nr. protokolli 609/20 i datës 23.09.2020; Certifikatë nga IKAP për kandidatin L.B i datës 07.10.2009; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për kandidatin L.B. i datës 31.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për L.B i datës 14.03.2022; Vërtetim nga MPB-AME për L.B i datës 24.02.2023; Letër Motivimi e kandidatit L.B; Certifikatë mbi dënimet penale e kandidatit L.B. i datës 27.02.2023; Aplikacioni i kandidatit G.D i datës 02.03.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për kandidatin G.D me numër Nr.970 i datës 01.12.2017; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për kandidatin G.D me numër Nr.1263 i datës 30.12.2008; Certifikatë nga UBT për kandidatin G.D e vitit 2005/2006; Shkresë nga Universiteti i Teknologjisë i Vjenës për kandidatin G.D i datës 10.11.2006; Vërtetim nga MPMS për kandidatin G.D i datës 05.06.2020; Ndryshim dhe plotësim i Aktit të Emërimit i kandidatit G.D i datës 10.06.2019; Vërtetim për përvojën e punës nga MB. për kandidatin G.D i datës 02.06.2022; Vendim për transferimin e përkohshëm të brendshëm në interes të

institucionit e kandidatit G.D. 01.02.2023; Dëshmi për masat disiplinore e kandidatit G.D i datës 02.06.2022; Letër referencë nga GMC për kandidatin G.D e datës 31.05.2012; Letërnjoftim i kandidatit G.D; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për kandidatin G.D i datës 02.03.2023; Letër motivimi i kandidatit G.D; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për kandidatin G.D; Certifikatë mbi dënimet penale e kandidatit G.D i datës 08.02.2023; Aplikacioni i kandidates V.A.M. i datës 03.03.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër Nr.600 i datës 21.01.2015; Diplomë nga Kolegji Viktori Prishtinë me numër Nr.427/16 i datës 05.02.2016; Referencë nga AMM i datës 11.04.2007; Letër referencë nga B2 e muajit korrik 2010; Letër referencë nga CCG i datës 19.03.2012; Letër referencë nga ADB e muajit gusht 2013; Certifikatë nga DRC i datës 22.09.2017; Certifikatë e punësimit nga DRC për kandidaten V.A.M i datës 24.01.2019; Letër rekomandim nga DRC për V.A.M. i datës 28.01.2019; Shtojcë e kontratës nga GIZ për kandidaten V.A.M e datës 20.02.2018; Pasqyra e llogarisë së trustit prej datës 10.05.2006-30.01.2023; Akt Emërim i kandidates V.A.M i datës 03.01.2019; Vendim nga MZHR me numër protokolli 470 i datës 05.05.2021; Vendim nga MZHR me numër protokolli 1218 i datës 21.12.2021; Vendim nga MZHR me numër protokolli 640 i datës 18.07.2022; Diplomë nga Kolegji Viktori Prishtinë për kandidaten V.A.M. me numër Nr.427/16 i datës 05.02.2016; Letërnjoftim i kandidates V.A.M.; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për kandidaten V.A.M i datës 30.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për kandidaten V.A.M i datës 28.01.2022; Vërtetim nga MZHR për kandidaten V.A.M i datës 02.03.2023; Letër motivuese e kandidates V.A.M i datës 03.03.2023; Mirënjohje nga MZHR për kandidaten V.A.M. i datës 30.12.2021; Mirënjohje nga MZHR për kandidaten V.A.M i datës 31.12.2020; CV-në e kandidates V.A.M.; Letër Rekomandim nga Works për kandidaten V.A.M i datës 15.04.2006; Certifikatë mbi dënimet penale e kandidates V.A.M e datës 01.03.2023; Aplikacioni i kandidates L.D i datës 02.03.2023; Diplomë nga Fakulteti i Gazetarisë "Faik Konica" me numër Nr.10 e datës 14.01.2005; Certifikatë e Notave nga Fakulteti i Gazetarisë "Faik Konica" me numër 349 e datës 08.11.2006; Rekomandim nga Fakulteti i Gazetarisë "Faik Konica" i datës 10.06.2005; Diplomë nga Kolegji Riinvest me numër Nr.82-02/8-15 e datës 04.06.2015; Akt Emërimi me numër Nr.0/39 i datës 12.12.2011; Vendim nga MAPL i datës 19.03.2007; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 05.11.2007; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 05.06.2009; Kontrata e marrëdhënies së punës e datës 26.04.2011; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 24.02.2015; Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit i datës 24.04.2017; Vendim nga MAPL i datës 26.06.2018; Letër referencë nga EU për kandidaten L.D i datës 18.06.2012; Letërnjoftim për kandidaten L.D; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 23.09.2021; Vërtetim mbi dëshminë e vlerësimit të punës nga AKK për kandidaten L.D i datës 24.10.2022; Formulari

për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për kandidaten L.D i datës 22.01.2021; Vërtetim nga APK për kandidaten L.D i datës 01.03.2023; Letër motivimi e kandidates L.D; Certifikatë nga Gjykata Themelore Prishtinë për kandidaten L.D i datës 16.11.2022; Aplikacioni i ankuesit XH.Z. i datës 24.02.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës me numër Nr.702 i datës 02.12.2009; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e datës 06.10.2020; Referencë nga DPH Restaurant i datës 10.02.2010; Referencë nga 26 Maji SHPK ankuesin i datës 01.07.2014; Vërtetim nga Njësia e Burimeve Njerëzore Komuna e Prishtinës ankuesin i datës 13.02.2023; Letërnjoftim ankuesit; Letër motivuese e ankuesit i datës 24.02.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e ankuesit e datës 02.02.2023; Aplikacioni i ankueses B.B. i datës 02.03.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës me numër Nr.898 e datës 08.11.2004; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me numër Nr.2273 e datës 16.01.2020; Vërtetim nga UNMIK i datës 09.07.2002; Vërtetim nga BSHE "afaristi" për ankuesen B. i datës 18.10.2013; Vërtetim nga SKQZ për ankuesen B.B. i datës 10.05.2016; Zyra e regjistrimit të popullsisë fletë rekomandim për ankuesen B.B i datës 31.12.2011; Akt Emërim i ankueses B.B i datës 08.12.2011; Vendim nga ANJF për ankuesen B.B i datës 18.12.2014; Vendim nga Kuvendi i Kosovës m numër Nr.ZK-60/12 i datës 12.11.2012; Vendim nga MFT për ankuesen B.B i datës 21.04.2020; Vendim nga MF për ankuesen B.B i datës 10.07.2020; Letër referencë e datës 28.08.2015; Letër referencë nga IFES për ankuesen B.B. i datës 05.02.2010; Letërnjoftim i ankueses B.B; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për ankuesen B.B i datës 20.01.2023, i datës 16.02.2023, i datës 06.07.2022, i datës 31.01.2021; Dëshmi për masë disiplinore e ankueses B.B i datës 27.02.2023; Certifikatë mbi dënimet personale e ankuese B.B e datës 02.03.2023; Aplikacioni i kandidatit A.I i datës 01.03.2023; Diplomë nga Universiteti "Hasan Prishtina" e kandidatit A.I me numër Nr.1164 i datës 08.07.2016; Diplomë nga Universiteti "Hasan Prishtina" e kandidatit A.I me numër Nr.73 e datës 12.11.2015; Letër referuese e datës 17.11.2014; Vërtetim mbi njohjen e përvojës së punës e kandidatit A.I e datës 27.04.2016; Vërtetim nga Kolegji Evropian Juridica për kandidatin A.I. i datës 03.05.2018; Vërtetim nga Juridica SHPK për kandidatin A.I. i datës 15.10.2018; Vërtetim nga Universiteti Publik "Kadri Zeka" për kandidatin A.I. i datës 14.07.2022; Certifikatë nga CISCO për kandidatin A.I e datës 10.09.2008; Letërnjoftim i kandidatit A.I.; Letër rekomandim e kandidatit A.I; Certifikatë nga CPSEI për kandidatin A.I e vitit 2011; CV-ja e kandidatit A.I; Certifikatë nga Eulex për kandidaten A.I e muajit tetor 2012; Aplikacioni i kandidates A.G.P i datës 27.02.2023; Diplomë nga Kolegji Universitar Biznesi për kandidaten A.G me numër Nr.69/13 i datës 05.07.2013; Diplomë nga Kolegji Universitar Biznesi për kandidaten A.G me numër Nr.21/16 i datës 20.06.2016; Certifikatë nga IAS për kandidaten A.G e datës 15.12.2015; Kontratë pune e kandidates A.G e datës 01.07.2012; Referencë nga për kandidaten A.G e datës 01.07.2012; Letërnjoftim i kandidates A.G.P; Pasqyra e llogarisë së trustit i kandidates A.G.P prej datës 01.12.2012-29.11.2021; Letër motivuese e kandidates A.G.P; Emailin nga A.S për C.Z. i datës 28.04.2023; Emailin nga C.Z për A.S i datës 28.04.2023; Konkurs pranimit hapur për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm i datës 02.11.2022; Konkurs pranimit hapur për pozitën "Drejtor i

Përgjithshëm i datës 25.01.2022; Konkurs pranimit hapur për pozitën "Drejtor i Përgjithshëm i datës 05.11.2021; Vendim për emërim të komisionit ad hoc me Nr.01/2022 i datës 17.01.2022; Vendim për emërim të komisionit Nr. 06/2022 i datës 21.12.2022; Rregullore Nr.01/2021 (AIP) për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Emailin nga A.S për C.Z i datës 29.05.2023; Emailin nga A.S për C.Z i datës 02.05.2023; Kërkesën për miratimin e plotësimit të përshkrimit të detyrave të punës për nëpunësit civil të AIP e datës 02.02.2023; Kërkesë për miratimin e plotësimit të përshkrimit të detyrave të punës për nëpunësit civil të AIP e datës 31.03.2022; Vendimin me numër protokollit 4150/2023 të datës 08.05.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Vendimit me numër protokollit 4075/2023 të datës 05.05.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Kolegji për Shqyrtimin Vendorsjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa, *është e pa bazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 07.03.2023 dhe 14.03.2023 pretendon të shqyrtohet kjo vendimmarrje për shkak se i njëjti organ po vendos edhe për procedurën e rekrutimit dhe i njëjti organ nuk kthen përgjigje/vendim sipas nenit 8 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, po ashtu pretendon se nuk është respektuar parimi i meritës dhe mundësive të barabarta për shkak që kam ofruar të gjitha dokumentacionet e nevojshme.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit përfundimtar të kandidatëve për pozitën *Drejtor i Përgjithshëm 1* në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, pretendon se vlerësimi i testit me shkrim dhe intervistës me gojë ka qenë shumë i dobët dhe jo profesionale nga ana e komisionit sepse nuk jam vlerësuar sipas meritës dhe jam diskriminuar në raport me kandidatët e tjerë në fazën të vlerësimit të testit me shkrim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, konstaton se në konkursin e shpallur 28.04.2022, për pozitën *Drejtor i Përgjithshëm 1* në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, kriteret formale të konkursit kanë qenë:

- *Diplomë Universitare me të paktën 240 kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to;*
- *Kualifikime të posaçme formale: nuk ka kërkesa të posaçme formale për këtë pozitë;*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku (8) vite përvojë pune profesionale,, duke përfshirë së paku pesë (5), vite përvojë punë në pozita drejtuese.*

Në këtë konkurs dokumentet që duhet paraqitur për aplikim kanë qenë: *"Kopje e diplomave mbi kualifikimin arsimor, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit; dëshmi për përvojë n e*

punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës që përcakton pozitën e punë si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë; letër motivimi; kopjen e letërnjoftimin/pasaportës etj...”

Ndërlidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses Bahrije Berisha, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se refuzimi aplikacioni është bërë për shkak që nuk ka ofruar dëshmi për me të cilën tregon interesim për aplikim në këtë pozitë gjegjësisht nuk ka dërguar letër motivuese, si rrjedhojë nga shqyrtimin i aplikacionit të ankueses respektivisht dëshmive të dërguara nga ankuesja e njëjta nuk ka dorëzuar **“Letrën Motivuese”**, konkretisht kandidatët lidhur me aplikimin kanë qenë të obliguar të dërgojnë edhe këtë dëshmi e cila ka qenë pikë e ka qenë kërkesë e pikës 7 të konkursit, po ashtu një dëshmi e tillë kërkohet edhe në bazë të nenit 6 paragrafi 6 nën paragrafi 6.15 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Informim dhe Privatësi me rastin e shqyrtimit të aplikacionit të ankueses ka vepruar në pajtim me kompetencat e përcaktuara me nenin 40 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë, i cili përcakton se: **“5. Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza: 5.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit, dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e Pranimin, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimin për pozita të kategorisë së lartë drejtuese”**, kështu që refuzimi i aplikacionit të ankueses është bërë në pajtim me kërkesat e konkursit dhe duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar nga ankuesja dhe meqenëse e njëjta nuk ka dorëzuar letrën motivuese atëherë konsiderohet që nuk ka plotësuar kushtet për të kaluar fazën e verifikimit paraprak, ngase me nenin 7 paragrafi 1, 2 dhe 3 i Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues është përcaktuar se cilat dokumentacione duhet të përmbaj aplikacioni për konkurrim, kështu që në kuptim të kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se verifikimi paraprak është bërë në pajtim me kërkesat e konkursit dhe në pajtim me nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Në bazë të provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, me rastin e njoftimit të datës 07.03.2023 të ankueses për refuzim të aplikacionit është bërë mbi bazë të kriterëve dhe në pajtim me nenin 8 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues i cili përcakton se: **“Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet për aplikim nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Njoftimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim arsyetohet duke përfshirë të gjitha kriteret dhe/ose dëshmitë e papërbushura dhe u dërgohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga data e publikimit të rezultateve”**, ndërsa ankuesja në bazë të paragrafit 6 të këtij neni, më datë 10.03.2023 ka parashtruar kërkesë për sqarime shtesë lidhur me rishqyrtimin e aplikacionit, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 14.03.2023 ka njoftuar ankuesen se është shqyrtuar

aplikacioni dhe nuk është identifikuar letër motivuese e cila ka qenë kërkesë e konkursit, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë për Informim dhe Privatësi me rastin e shqyrtimit të kërkesës së datës 10.03.2023 të ankueses ka vepruar në pajtim me nenin 8 paragrafi 7 dhe 8 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues i cili përcakton se: *“7. Njësia Përgjegjëse, brenda afatit prej pesë (5) ditëve kalendarike duhet të përgjigjet me shkrim në kërkesën e kandidatit si në paragrafin 6 të këtij neni, duke dhënë arsyet e detajuara për mos kualifikim për konkurrim të mëtejshëm. 8. Kandidati i pa kënaqur me përgjigjen me shkrim si në paragrafin 7 të këtij neni, ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit prej tetë (8) dite kalendarike pas pranimit të përgjigjes.”*, si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të kësaj dispozite nuk është përcaktuar që Njësia e Burimeve Njerëzore duhet të nxjerr vendim me rastin e shqyrtimit të kërkesës siç pretendon ankuesja, sepse ankuesja ka marrë përgjigje me shkrim lidhur me kërkesën e datës 10.03.2023 përmes emailit të datës 14.03.2023 duke ju dhënë arsyet konkrete dhe të qarta se cilat kanë qenë shkaqet për refuzimin e aplikacionit të saj, kështu që ky pretendim i ankueses është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankueses se në këtë procedurë janë shkelur parimet e përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit, konstaton se në raport me ankuesen dhe kandidatët e tjerë aplikacioni është shqyrtuar në mënyrë të drejtë dhe në pajtim me dispozitat e lartcekura, sepse në këtë procedurë të gjithë kandidatët janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe shqyrtimi i aplikacioneve të tyre është bërë në bazë të parimit të meritës, ngase janë shqyrtuar të gjitha dokumentacionet e ofruara nga vetë kandidatët në raport me kërkesat e përgjithshme formale dhe kërkesat e tjera të përcaktuara me konkurs, në këtë kuptim Kolegji i Këshillit, konstaton se janë respektuar parimet e pranimit të zyrtarëve publikë të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Kolegji i Këshillit, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me procedurën e pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, përkatësisht:

Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë-Neni 40 paragrafi 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, ka përcaktuar se: *“2. Konkurrimi organizohet nga ministria përgjegjëse për administratën publike për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, për çdo institucion tjetër shtetëror (në vijim Njësia e Pranimit). 3. Hapja e procedurës së konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 30 ditë, përpara datës të caktuar për paraqitjen e aplikimit, nga Njësia e Pranimit, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me njëzetë të tjera të përshtatshme. 4. Shpallja e konkurrimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, përfshin pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi, përshkrimi i punës, kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, që duhet t'i plotësojnë kandidatët, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e konkurrimit, dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim dhe afatin për paraqitjen e aplikimit. 5. Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza: 5.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme*

dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit, dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e Pranimit, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidatëve, nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese, bëhet nëpërmjet një procedure vlerësimi, që përfshin një testim elektronik dhe një testim me gojë. Në testimin me shkrim sigurohet anonimiteti i konkurrentëve. Komisioni i vlerësimit mund të asistohet në procesin e vlerësimit nga subjekte të specializuara të fushës së përzgjedhjes të burimeve njerëzore. 8. Jo më shumë se tre (3) kandidatët e vlerësuar, nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Me emrat e kandidatëve fitues njoftohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ata bëhen publik nga Njësia e pranimit në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ-së dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Kandidatët që nuk janë fitues njoftohen personalisht dhe kanë të drejtën e ankimit në KPMSHCK, në afat kohor 8 dite kalendarike”.

Rregulloren (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues-Neni 8 paragrafi 1 dhe 2, ka përcaktuar se: “1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikacionit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak”, Neni-10 paragrafi 1, 2 dhe 3, është përcaktuar se: “1. Vlerësimi profesional i kandidatëve për emërimin në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese në institucionin tjetër shtetëror bëhet nga Komisioni i Pranimit (në tekstin në vijim KP) i cili themelohet në pajtim me paragrafin 5 të nenit 41 të Ligjit për Zyrtarët Publikë. 2. Kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pranimit në institucionin tjetër shtetëror si në paragrafin 5.2 të nenit 41 të Ligjit për Zyrtarët Publikë (dy nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese), duhet t’i plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafin 2 të nenit 9 të kësaj Rregullore. 3. Njësia Përgjegjëse e institucionit, përgatit listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara si në paragrafin 2 të nenit 9 të kësaj Rregullore dhe e dërgon tek titullari i institucionit”, Neni 13 paragrafi 1, 7, 12, 13, 14, 15, 16, 18 dhe 19, ka përcaktuar se: “1. Vlerësimi profesional i kandidatëve nga lista e kandidatëve si në paragrafin 2 të nenit 10 të kësaj Rregullore bëhet nga Komisioni Shtetëror i Pranimit, për pozitat në institucionet e administratës shtetërore dhe nga Komisioni i Pranimit, për pozitat në institucionin tjetër shtetëror (në tekstin në vijim për dy komisionet – Komisioni). 7. Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është pesëdhjetë (50) pikë, duke përfshirë vlerësimin maksimal deri në pesëmbëdhjetë (15) pikë për pyetjen për prezentim dhe vlerësimin maksimal deri në tridhjetë e pesë (35) pikë për pyetjet tjera të intervistës me gojë. 12. Vlerësimi i kandidatëve bëhet sipas një procedure që përfshin pikët maksimale për secilën nga fazat e vlerësimit siç është përcaktuar në këtë nen. 13. Komisioni merr vendim për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve sipas numrit të pikëve. Secili prej anëtarëve jep vlerësimin e tij të pavarur dhe individual për secilin kandidat. Vlerësimi përfundimtar për secilin kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve të komisionit. 14. Vendimi si në paragrafin 13 të këtij neni merret jo më vonë se tre (3) ditë kalendarike nga përfundimi i procedurës së vlerësimit profesional dhe përmban: vlerësimin individual të çdo kandidati, numrin e pikëve të fituara të çdo kandidati dhe arsyetimin individual për vlerësimin e çdo kandidati. 15. Komisioni, në bazë të

vendimit si në paragrafin 14 të këtij neni përgatit listën e kandidatëve me më shumë se 70 për qind të pikëve dhe renditjen e tyre e bënë duke filluar nga kandidati me më shumë pikë. 16. Jo më shumë se tre (3) kandidatë dhe jo më pak se dy (2) kandidatë të vlerësuar nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 e më shumë për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe bashkë me poentimet e tyre, propozohen, për përzgjedhje përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 18. Lista e kandidatëve si në paragrafin 15 të këtij neni publikohet në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit për nëpunësit civilë dhe ueb faqen e institucionit. 19. Kandidatët që nuk janë fitues njoftohen personalisht nga njësia përgjegjëse dhe kanë të drejtën e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit prej tetë (8) ditëve kalendarike pas pranimit të njoftimit”.

Kolegji i Këshillit, marr parasysh dispozitat e cekura si më lartë si dhe provat materiale, vlerëson se Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit me Nr. 06/2022 të datës 21.12.2022 për këtë pozitë është themeluar në pajtim me nenin 41 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: “5. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese, që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror, është ad hoc. Ai themelohet nga titullari i institucionit dhe përbëhet nga: 5.1. një përfaqësues i Njesisë përgjegjëse të institucionit; 5.2. dy nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese nga institucioni apo nga një institucion tjetër i Shërbimit Civil me përgatitje të veçantë në procesin e përzgjedhjes; 5.3. dy ekspert të jashtëm në procesin e përzgjedhjes nga organizata të specializuara”, dhe nenin 10 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Lidhur me pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me vlerësimin e testit me shkrim, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se testimi me shkrim për kandidatët që i janë nënshtruar është bërë në pajtim me dispozitat e lartcekura, me çka rezulton se ankuesi në testin me shkrim ka marr gjithsej 28.05 pikë, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, vlerëson se nuk është konstatuar ndonjë shkelje në këtë procedurë dhe ankuesi nuk ka mund të argumentoj me asnjë provë konkrete pretendimet e tij, kështu që ky pretendim është i pabazuar, ngase nuk ka tejkalim të dispozitave procedurale dhe materiale por ka respektim të dispozitave të lartcekura.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit se procesi i vlerësimit të intervistës me gojë nga Komisioni i Pranimit është bërë në mënyrë jo reale dhe në kundërshtim me parimin e meritës, Kolegji i Këshillit, konstaton se procesi i intervistës me gojë është proces i cili vlerësohet për aq sa kandidati është i gatshëm të jap përgjigjet e tij dhe mbi bazë të përgjigjeve bëhet edhe vlerësimi, në këtë rast ankuesi në këtë fazë është vlerësuar me gjithsej 11.5 pikë, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit vlerëson se edhe në këtë fazë nuk është evidentuar ndonjë shkelje e dispozitave procedurale dhe materiale, ngase vlerësimi është bërë në kuadër të kornizës ligjore dhe kompetencave të Komisionit të Pranimit si dhe pragut të vlerësimit.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të provave materiale, ka gjetur se ankuesi nga të dyja fazat e vlerësimit respektivisht vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë është vlerësuar me gjithsej 39.55 pikë, me çka rezulton se nuk ka marr pikët e nevojshme të jetë kandidat i listës fituese, kështu që Kolegji i Këshillit konstaton se nuk është provuar me asnjë provë që Komisioni i Pranimit ka bërë vlerësime jo të drejtë të ankuesit në raport me kandidatët e tjerë, rrjedhimisht nuk janë gjetur rrethana të diskriminimit, andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se renditja përfundimtare e kandidatëve si dhe njoftimi i datës 30.03.2023 me kandidatë fitues është bërë në pajtim me dispozitat e lartcekura, kështu që të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Ndërsa sa i përket vlerësimi të dosjeve të ankuesit dhe kandidatëve fitues, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi posedon Diplomën me Nr.702 të datës 02.12.2009 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës/Fakulteti Juridike përmes të cilës dëshmohet se më datë 11.07.2009 ka përfunduar studimet themelore duke marr titullin Bachelor i Drejtësisë, posedon e studimeve master të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës/Fakulteti Juridik përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar studimet master në këtë fakultet, lidhur me përvojën e punës në bazë të Vërtetimit me Nr. 015 të datës 13.02.2023 është në marrëdhënie pune nga data 15.01.2015 në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Pronësi, Shpronësim dhe Këmbime. Kandidatja fituese posedon Diplomën me Nr. 10 të datës 14.01.2005 të lëshuar nga Fakulteti i Gazetarisë "Faik Konica" me të cilën ka marr titullin Gazetare e Diplomuar, posedon Diplomën me Nr. 82-02/8-15 të datës 04.06.2015 të lëshuar nga Kolegji Universitar RINVEST përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar nivelin master të studimeve duke marr titullin Master në Menaxhim Transparent i Buxhetit Komunal, lidhur me përvojën e punës sipas Kontratës së Marrëdhënies së Punës nga data 31.10.2007 deri më datë 24.02.2015 në pozitën Udhëheqëse e Zyrës për Informim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 25.02.2015 deri më datë 24.04.2017 ka punuar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit të Komunikimit dhe Informimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 24.04.2017 nga kjo datë deri më datë 26.06.2018 ka mbajtur pozitën e Udhëheqëse së Divizionit për Bashkëpunim Ndërkomunal në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, sipas Vendimit të datës 26.06.2018 është caktuar ushtruese e detyrës në pozitën Udhëheqëse e Departamentit për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal, ndërsa nga data 06.03.2019 punon në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit në pozitën Koorditore e Zyrës për Komunikim me Publikun dhe Media. Kandidati fitues Besim Kamberaj posedon Diplomën me Nr. 550 të datës 05.06.2023 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës/Fakulteti Ekonomik me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore duke marr titullin Ekonomist i Diplomuar, posedon Diplomën me Nr. 2671 të datës 07.04.2006 të lëshuar nga shteti i Rumanisë më të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet Master dhe në bazë të Vendimit me Nr. 6-774 të datës 18.09.2014 të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është bërë nostrifikimi i diplomës së fituar në shtetin e Rumanisë në Universitetin e Bukureshtit me të cilën dëshmohet se ka marr titullin Master në Programin Informatikë dhe Biznes, lidhur me përvojën e punës posedon Vërtetimin e datës 11.04.2017

të lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ku dëshmohet se nga data 22.06.2003 deri më datë 31.12.2003 ka qenë i punësuar në Departamentin e Administratës Lokale të kësaj ministrie, prej datës 01.07.2005 deri më datë 11.04.2017 ka punuar në këtë ministri në pozitën Udhëheqës i Departamentit për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal, sipas Vendimit me Nr. 01/2017 të datës 26.09.2017 është caktuar ushtrues detyre në pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, sipas Vendimit me numër protokolli 924 të datës 28.09.2020 është caktuar zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal. Rrjedhimisht sipas këtyre dëshmive por edhe dëshmive të tjera që janë kërkuar sipas konkursit, Kolegji i Këshillit, konstaton se edhe ankuesi po ashtu edhe kandidatët e listës fituese kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Bazuar në gjendje faktike dhe bazën juridike të vërtetuar si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se procedura e pranimit për pozitën *Drejtor i Përgjithshëm 1* në Agjencinë për Informim dhe Privatësi është zhvilluar në pajtim me nenin 6 dhe 40 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, andaj bazuar nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.591/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve
- Komisionerit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.